



KRU. "Gjakova" SH.A. Gjakovë



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 197/24 Dt. 14.03.2024

KRU. "GJAKOVA" SH.A. Gjakovë			
Marrë në datën: 14.03.2024			
Njësia org.	Numri	Shtorja	Vlera
	101		



Komuna Prizren

MARRËVESHJE

PËR BASHKËFINANCIM NË REALIZIMIN E PROJEKTIT "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Zojzë dhe Medvec të Komunës së Prizrenit dhe të Komunën së Mamushës" në komunën e Prizrenit

E lidhur me datën _____ në mes të palëve

KRU. "Gjakova" SH.A., Gjakovë, të cilën e përfaqëson, U.D. Kryeshefi Ekzekutiv z. Visar Hasi, Ofruesi i Shërbimeve të ujit të pijes.

Komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson, Kryetari i Komunës z. Shaqir Totaj

Vendosen

Të lidhin këtë marrëveshje me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1.1 Ministria e Ekonomisë dhe KRU. "Gjakova" SH.A., kanë arritur marrëveshje për financimin e disa projekteve kapitale ku objekt i kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i një pjese të projektit për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Zojzë dhe Medvec të Komunës së Prizrenit.

1.2 Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i një pjese të projektit "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Zojzë dhe Medvec të Komunës së Prizrenit dhe të Komunën së Mamushës".

Neni 2

Obligimet e palëve në marrëveshje

2.1. Palët në marrëveshje, Komuna e Prizrenit dhe K.R.U. "Gjakova" SH.A. Gjakovë, u dakorduan që të bashkë financojnë një pjesë të projektit në realizimin e projektit "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Zojzë dhe Medvec të Komunës së Prizrenit dhe të Komunën së Mamushës".

2.2. Kostoja totale e projektit sipas para masës dhe parallogarisë përfshinë vlerën **1,300.000.00 €**.

2.3. Bazuar në Marrëveshjen e dt.06.02.2024 Ministria e Ekonomisë është zotuar që të participoj në shumë prej **700,000.00 €**, për realizimin e këtij projekti.

2.4 Kostoja financiare e bashkëfinancimit të një pjese të projektit Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Zojz dhe Medvec të Komunës së Prizrenit është në vlerë prej **600,000.00 €**.

2.5. Në pajtim si në paragrafin 2.4, të këtij neni, palët në Marrëveshje u dakorduan që Komuna e Prizrenit nga buxheti i saj do të participoj në shumën prej **300.000.00 €** sipas kësaj marrëveshje, ndërsa K.R.U. "Gjakova" SH.A. po ashtu do të participojë në shumën prej **300.000.00 €**, sipas kësaj marrëveshje.

2.6. Pagesa e faturave do të behet nga ana e K.R.U. "Gjakova" SH.A, në llogari të O.E. në bazë të faturave që do ti prezantojë, dhe në bazë të dinamikës së punimeve të kryera.

2.7. Komunës së Prizrenit do ti prezantohet situacioni i punimeve të kryera së bashku me faturat, si dhe dëshmitë tjera të bashkangjitura sipas të cilave Komuna e Prizrenit do të transferoj mjetet në llogari të K.R.U. "Gjakova" SH.A. Nr. 1306001500002065 Banka BPB.

Neni 3 Procedura e Prokurimit

3.1. Procedurën e prokurimit në realizimin e projektit si në nenit 1, paragrafin 1.2, të kësaj marrëveshje, për zgjedhjen e operatorit-kryesit të punimeve, do ta zhvillojë K.R.U. "Gjakova" SH.A.

Neni 4 Rregullat tjera

4.1. Investimi i përbashkët i këtij projekti me bashkëfinancim, palët u dakorduan që të jenë në pronësi të K.R.U. "Gjakova" SH.A. si ofrues i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

4.2. Kësaj Marrëveshjes i bashkëngjitet paramasa dhe parallogaria e Projektit: "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Zojz dhe Medvec të Komunës së Prizrenit dhe të Komunës së Mamushës".

Neni 5 Mosmarrëveshjet

5.1. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje, pajtohen që mos marrëveshjet të zgjidhen me mirëkuptim dhe në frymën e marrëdhënieve të mira.

5.2. Çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë marrëveshje duhet të rregullohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës, si dhe aktet tjera ligjore.

Neni 6

Hyrja në Fuqi e Marrëveshjes

6.1. Kjo marrëveshje është lëshuar në dy kopje origjinale, ku secila nga palët do të mbaj nga një kopje.

6.2. Kjo marrëveshje, hynë në fuqi dhe duhet të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.


PALËT KONTRAKTUESE

Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
"GJAKOVA" SH.A. Gjakovë
U.D. Kryeshefi Ekzekutiv


z. Visar Hasa



Komuna e Prizrenit
Kryetar i Komunës


z. Shaqir Totaj

